

## NORMA EFEKTIVE E INTERESIT

Shembuj të llogaritjes së normës efektive të interesit (NEI)

Kredia Ekspres

Monedha	Shuma	Periudha	Norma e Interesit	NEI
ALL	500,000	5 vjet	8.50%	9.37%

Kredia për Shtëpi

Monedha	Shuma	Periudha	Norma e Interesit	NEI
ALL	4,000,000	30 vjet	4.5%	5.3%
EUR	40,000	30 vjet	4.5%	5.25%
USD	40,000	30 vjet	7.5%	8.18%

\* Është marrë në konsideratë norma minimale e interesit pas vitit të parë të kredisë.

Në përlllogaritjen e NEI përfshihen edhe kostot e sigurimit të jetës dhe të pronës (në rastet kur aplikohet) si dhe komisioni i administrimit sipas kushteve të punës në fuqi. NEI ndryshon në varësi të ndryshimit të kohëzgjatjes së kredisë dhe kostove të aplikuara.

Metoda e llogaritjes së normës efektive të interesit për kredinë

Ekuacioni bazë për llogaritjen e normës efektive të interesit (NEI), barazon në një bazë vjetore, nga njëra anë vlerën totale faktike të kredisë, duke zbritur çdo shpenzim të mbajtur (për shembull, shpenzimet administrative etj.) të vënë në dispozicion të klientit sipas marrëveshjes së kredisë dhe në anën tjetër vlerën totale faktike të shlyerjeve dhe/ose të pagesave të shpenzimeve:

$$\sum_{k=1}^m K_k (1+i)^{-tk} = \sum_{l=1}^{m'} R_l (1+i)^{-tl}$$

Kuptimi i shkronjave dhe simboleve:

$m$  – është numri total i kësteve të kredisë, nëse lëvrimi i kredisë bëhet me këste të paguar nga kredidhënësi.

$k$  – është numri në vazhdimësi për këstet e kredisë, nëse lëvrimi i kredisë bëhet me këste të paguara nga kredidhënësi, kështu që  $1 < k < m$  dhe/ose  $1 = k = m$ .

$K_k$  – është vlera faktike e kredisë së vënë në dispozicion të klientit në periudhën  $k$ .

$tk$  – është intervali, i shprehur në vite dhe fraksione të një viti, ndërmjet datës së vlerës së këstit të parë të kredisë të vënë në dispozicion të klientit (nëse lëvrimi i kredisë bëhet me këste) dhe datës së çdo kësti pasues të kredisë të vënë në dispozicion të klientit, domethënë  $t_1 = 0$ .

$m'$  – është numri total i kësteve të paguara nga klienti për shlyerjen e kredisë dhe/ose pagesave të shpenzimeve.

$l$  – është numri në vazhdimësi i kësteve të paguara nga klienti për shlyerjen e kredisë (shlyerja ose pagesa e shpenzimeve).

$R_l$  – është vlera e këstit të shlyerjes ose pagesës së shpenzimeve nga klienti në periudhën  $l$ .

$tl$  – intervali, i shprehur në vite dhe fraksione të një viti, ndërmjet datës së vlerës së këstit të parë të kredisë të vënë në dispozicion të klientit (nëse lëvrimi i kredisë bëhet me këste) ose datës së lëvrimit të kredisë, në rast se lëvrimi i kredisë bëhet i plotë dhe datës së çdo kësti për shlyerje dhe/ose pagimi shpenzimesh vijuese që paguan klienti.



i=NEI mund të llogaritet (nga algjebra ose nga një program kompjuteri) kur termat e tjerë në ekuacion janë të njohur nga kontrata ose ndryshe.

Për një përllogaritje sa më të saktë të NEI, ju lutemi drejtohuni pranë një prej degëve të OTP Bank Albania.